

**VENDIM**  
**Nr.147, datë 8.3.2006**

**PËR LEJIMIN E MINISTRISË SË ARSIMIT DHE TË SHKENCËS TË KRYEJË  
PROCEDURAT E PROKURIMIT, NË EMËR TË INSTITUCIONEVE TË VARËSISË,  
PËR NDËRTIMIN DHE RIKONSTRUKSIONIN E OBJEKTEVE SHKOLLORE, PËR  
FURNIZIMIN ME MJETE DIDAKTIKE, DEMONSTRATIVE DHE DOKUMENTACION  
SHKOLLOR, SIPAS NEVOJAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5 të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006”, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Lejimin e Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës, që, për fondet e miratuara në buxhetin e vitit 2006, për institucionet në varësi të saj, të kryejë procedurat e prokurimit, në emër të këtyre institucioneve, për ndërtimin dhe rikonstruksionin e objekteve shkollore, për furnizimin me mjete didaktike, demonstrative dhe dokumentacion shkollor, sipas nevojave, të përcaktuara në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ministria e Arsimit dhe e Shkencës të prokurojë fondin e përgjithshëm, të llogaritur si shumë e fondeve buxhetore, të miratuara për çdo ent varësie, në Buxhetin e Shtetit të vitit 2006, për ndërtimet, rikonstruksionet, si dhe mallrat e përcaktuara në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Kontratat me subjektet fituese, pas përfundimit të procedurave të prokurimit nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës, të lidhen nga institucionet, në emër të të cilave është zhvilluar prokurimi, për fondin e vënë në dispozicion dhe sipas nevojave të paraqitura prej tyre.

4. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe e Shkencës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**LISTA E PROKURIMEVE PUBLIKE QË DO TË PËRQËNDROHEN PËR T’U ZHVILLUAR  
NË MINISTRINË E ARSIMIT**

| Nr. | Objekti i prokurimit                                            | Fondi limit i përgjithshëm |            | Koha e zhvillimit të tenderit | Procedura e prokurimit | Burimi i financimit |
|-----|-----------------------------------------------------------------|----------------------------|------------|-------------------------------|------------------------|---------------------|
|     |                                                                 | Investime                  | Shpenzime  |                               |                        |                     |
|     | <b>NDËRTIME DHE RIKONSTRUKSIONE</b>                             |                            |            |                               |                        |                     |
| A.  | Objekte në funksion të arsimit të mesëm profesional             |                            |            |                               |                        |                     |
| 1   | Rik shk mesme H.Turizmi Tiranë                                  | 60 000 000                 |            | Maj 2006                      | T.H.përq në MASH       | Buxhet Shteti       |
| 2   | Rik shk.mesme Futbollit Tiranë                                  | 70 000 000                 |            | Prill 2006                    | T.H.përq në MASH       | Buxhet Shteti       |
| 3   | Sistemi ngrohje Konv, Ped Elbasan                               | 13 000 000                 |            | Prill 2006                    | T.H.përq në MASH       | Buxhet Shteti       |
| 4   | Sistem ngrohje konvikt dhe shk.prof.të rik 2005, Korçë          | 12 900 000                 |            | Maj 2006                      | T.H.përq në MASH       | Buxhet Shteti       |
| 5   | Konv shk mes “Demir Progri”, Korçë                              | 20 500 000                 |            | Maj 2006                      | T.H.përq në MASH       | Buxhet Shteti       |
| 6   | Shkolla mesme pyjore Shkodër                                    | 25 000 000                 |            | Prill 2006                    | T.H.përq në MASH       | Buxhet Shteti       |
| 7   | Sistemi i ngrohjes Konvikte+shkolla prof të rik në vitin 2005,Q | 20 000 000                 |            | Maj 2006                      | T.H.përq në MASH       | Buxhet Shteti       |
| 8   | Rikonstruksion i shkollës së mesme industriale, Vlorë           | 27 000 000                 |            | Prill 2006                    |                        |                     |
|     | <b>MALLRA</b>                                                   |                            |            |                               |                        |                     |
|     | Mallra në funksion të arsimit të detyrueshëm dhe të mesëm       |                            |            |                               |                        |                     |
| 1   | Blerje mjete didaktike, arsimit bazë                            |                            | 96 000 000 | Prill 2006                    | T.H.përq në MASH       | Buxhet Shteti       |
| 2   | Blerje mjete didaktike, arsimit i mesëm                         |                            | 25 000 000 | Prill 2006                    | T.H.përq në MASH       | Buxhet Shteti       |
| 3   | Dokumentacion shkollor (dëftesa, regjistra etj.)                |                            | 18 820 000 | Mars 2006                     | T.H.përq në MASH       | Buxhet Shteti       |